VENDIM
Nr.89, datë 26.9.2011

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË SHOQËRISË "MALIDO ENERGJI" SHPK PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR "HEC KLOS" SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "ll", 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa "d", të "Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s" të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21 datë 18.3.2009, dhe neneve 7 dhe 8 të "Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme" të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 26.9.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Malido Energji" sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues për "Hec Klos" si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria "Malido Energji" sh.p.k. është konform rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 germat "a", "b", "c", "d"
- Përshkrimi i përgjithshëm i centralit

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7 pika 2 germat "a", "b", "c", "d"

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3 germat "a", "b", "c"

Përshkrimi i centralit...

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Malido Energji" sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për "Hec Klos" si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani